



Prishtinë, 27 gusht 2020
Kodi i ZRRE-së: V_1269_2020

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Duke u bazuar në:

1. Dispozitat e Nenit 15 paragrafi 1 dhe Nenit 26 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë Nr.05/L-084
2. Dispozitat e Nenit 6.3 të Rregullës për Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në sektorin e Energjisë.
3. Dispozitat e Nenit 9 të licencës për furnizim publik me ngrohje qendrore të NQ Termokos.
4. Kërkesën e datës 9.06.2020 për ndryshimin dhe plotësimin e "Procedura për Shqyrtimin e Ankesave dhe Kërkesave të Konsumatorëve" nga ndërmarrja NQ "Termokos" SH.A., adresa: rruga "28 Nëntori", pn-Dardani/Prishtinë, Republika e Kosovës.

në seancën e mbajtur më 27 Gusht 2020 nxori këtë:

VENDIM

- I. APROVOHET "Procedura për Shqyrtimin e Ankesave dhe Kërkesave të Konsumatorëve" të NP "Termokos" Sh.A.**

Arsyetim

1. Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) më datë 09.06.2020 ka pranuar kërkesën e të licencuarit- NP Termokos SH.A. për ndryshim plotësimin e dokumentit "Procedura e shqyrtimit të ankesave dhe kërkesave të konsumatorëve" .
 2. Pas shqyrtimit të draft-Procedurës të dorëzuar nga NP "Termokos" SH.A dhe përmirësimit e plotësimit të tij sipas komenteve të ZRRE-së, Bordi i ZRRE -së duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- II. I licencuari obligohet që pas pranimit të këtij vendimi menjëherë ta publikojë këtë Procedurë në faqen e tij elektronike zyrtare.**
 - III. Vendimi nxirret në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës.**




- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Kundër këtij Vendimi palët e pakënaqura mund t'i drejtohet Gjykatës Kompetente, brenda (30) ditësh nga pranimi i Vendimit ose nga data e publikimit të Vendimit në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Shtojcë: "Procedura e shqyrtimit të ankesave kërkesave të konsumatoreve të NP " Termokos " SH.A.

Bordi i Rregullatorit:


Arsim Janova, u.d. kryesues


Besim Sejfiqaj, anëtar


Selman Hoti, anëtar


Izet Rushiti, anëtar

Vendimi i dërgohet:

N. P Termokos.Sh.A

Arkivit te Rregullatorit